**DHJETOR 2024**

<table>
<tr><th>Nr. (1)</th><th>Data e regjistrimit të kërkesës (2)</th><th>Objekti (3)</th><th>Data e kthimit të përgjigjes (4)</th><th>Përgjigja(5)</th><th>Statusi i kërkesës (6)</th><th>Tarifa (7)</th></tr>
<tr><td>73</td><td>2.12.2024</td><td>Citizens.al po punon për të kryer një raportim ndërkufitar për situatën e lumit Drin sa i takon nivelit të ndotjes, ndërhyrjeve urbane etj. për këtë duam të vihemi në dijeni për pyetjet/kërkesat si më poshtë: 1. Sa shpesh kryhet monitorimi i cilësisë së ujit të lumenjve të Drinit dhe cilat janë rezultatet e fundit? 2. A ka ndonjë projekt të BE-së, autoriteteve lokale apo qendrore për trajtimin e ujërave të ndotura në zonat urbane rreth rrjedhës së degëve të Drinit? 3. Si ndikon ndotja e lumit në ekosistemet natyrore dhe a janë marrë masa për mbrojtjen e peshqve dhe bimësisë? 4. Cilat janë penalitetet për ndotësit e</td><td>17.12.2024</td><td>Baseni i Drinit monitorohet në 6 stacione kampionimi që nga stacioni i referencës, burimi i tij deri para derdhjes në det. Stacionet janë paraqitur në formë tabelore si vijon:
<table>
<tr><th>Nr.</th><th>Kodi i kampionit</th><th>Emërtimi i Lumit</th><th>Vendndodhja</th></tr>
<tr><td>1.</td><td>D1</td><td>Drini i Zi</td><td>Topojan – Ura Burrel Peshkopi</td></tr>
<tr><td>2.</td><td>D2</td><td>Drini</td><td>Bahçallek– Ura Bahçallek</td></tr>
<tr><td>3.</td><td>D3</td><td>Drini i Bardhë</td><td>Luma - Kukës</td></tr>
<tr><td>4.</td><td>Bu1</td><td>Buna</td><td>Muriqan – afër fshatit, në kufi</td></tr>
<tr><td>5.</td><td>Bu2</td><td>Buna</td><td>Ura e vjetër Shkodër - Shirokë</td></tr>
<tr><td>6.</td><td>DLe</td><td>Drini Lezhë</td><td>Kune – Vain para derdhjes në det</td></tr>
</table></td><td>Përfunduar</td><td>0</td></tr>
</table>

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | identifikuar dhe sa raste janë ndëshkuar në vitet e fundit? | | Monitorimi kryhet 4 here/vit ne përputhje me Direktivën Kuadër të Ujit. Të dhënat e monitorimit dhe raporti janë të aksesueshme ne faqen zyrtare te AKM https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/<br>Ju bëjmë me dije se mbështetur në Vendimin Nr. 568 datë 17.07.2019 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, si dhe në zbatim të Ligjit Nr. 10 433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin ne Republikën e Shqipërisë”, të Ligjit Nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës, kryen inspektime të programuara për subjektet që janë të pajisura me leje mjedisi të tipit A dhe B, si dhe me indicje nga palët e treta.<br>AKM ne përfundim te realizimit te monitorimit, përpunon te dhënat dhe identifikon pikat e monitorimit ku tejkalojnë normat e lejuara dhe vlerëson shkaqet e ndotjes, si dhe duke dhëne rekomandime. AKM me ane te shkresave zyrtare njofton bashkitë përkatëse me problematikat e identifikuara ne terren.<br>Sa i takon pyetjes suaj në lidhje me projektet e Bashkimit Evropian, ju bëjmë me dije se trajtimi i ujerave te ndotura nuk është ne kompetencën e AKM por te një institucioni tjetër, AKUK. | | |
| 74 | 5.12.2024 | Kërkesë për informacion ne lidhje me: Në kuadër të shpalljes së Lumit të Vjosës Park Kombëtar, kërko të më vihet në dispozicion | | Kthyer përgjigje me shkresë nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | informacioni si më poshtë: 1 – Në bazë të çfarë dokumentacioni, studimi dhe vlerësimi është shpallur Lumi Vjosa dhe degët e tij Park Kombëtar? Kërkoj të më vihen në dispozicion dokumentacioni; 2 – A ka pasur një vlerësim fillestar mbi gjendjen e Lumit Vjosa dhe degës së tij Drinos mbi gjendjen e tyre përpara shpalljes Park Kombëtar? Nëse po, kërkoj të më vihet në dispozicion dokumentacioni. 3 – A ka një vlerësim aktual (pas shpalljes së Lumit Vjosa dhe degëve të tij në Mars 2023) për impaktin e shpalljes së tij si Park Kombëtar? Kërkoj të më vihet në dispozicion dokumenti nëse ka. 4 – A ka një plan veprimi për zbatimin e statusit Park Kombëtar të Lumit Vjosa dhe degëve të tij? Nëse po, kërkoj të më vihet në dispozicion dokumentacioni. 5 – A ka një plan specifik të dedikuar për degët e Lumit Vjosa, si Lumi Drinos? Nëse po, | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kërkoj të më vihet në dispozicion dokumentacioni. | | | | |
| 75. | 09.12.2024 | Kërkesë për informacion ne lidhje me: - Sa inspektime janë kryer nga AKM në subjektin **** me objekt: "Zbatimi i lejes mjedisore"<br><br>2- Ju lutem na vini në dispozicion këto raporte inspektimi.<br><br>3- Na vini ne dispozicion raportin e inspektimit të kryer në kompaninë *** në muajin shtator 2024 me objekt: "Zbatimi i lejes mjedisore" dhe dokumentin e masës administrative për pezullim të aktivitetit të transferimit të mbetjeve të rrezikshme"<br><br>4- A ka AKM një Regjistër Kombëtar të Transfertave të Mbetjeve të Rrezikshme, bazuar në VKM 371 (2014) dhe a ka raportuar kompania *** për transfertat e saj të mbetjeve të rrezikshme sipas kritereve të përcaktuara në këtë VKM? | 13.12.2024 | Kthyer përgjigje nga AKM | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 5- Sa transferta ka raportuar *** në këtë regjistër dhe a kanë qenë këto raportime brenda afatit kohor të përcaktuar në dispozitat ligjore?<br><br>6- Nëse kjo s'ka ndodhur, cilat kanë qenë veprimet e ndërmarra nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ndaj kompanisë? | | | | |
| 76 | 16.12.2024 | Kërkesë për informacion ne lidhje me: Sa projekte zhvillimore ka ndërmarrë Ministria e Turizmit në kuadër të programit "100 fshatrat"? Sa është vlera e investimit? Ju lutem na vini në dispozicion listën e projekteve që ka përfituar secili prej tyre dhe llojin e ndërhyrjes së përfituar...<br><br>- Deri kur parashikohet të zgjasë projekti 100 fshatrat? A keni një model zhvillimi për të ardhmen e këtyre fshatrave?<br><br>- A keni ndërtuar një mekanizëm kontrolli se si | 27.12.2024 | Në vijim të e-mail-it tuaj ju bëjmë me dije si vijon: Programi i Integruar për Zhvillimin Rural- program I 100 fshatrave me përfshirjen e MBZHR dhe Ministrinë e Kulturës , është një nisme e Qeverise Shqiptare për te prezantuar instrumente zhvillimi ekonomik, social, kulturor, duke shfrytëzuar oportunitetet e secilit fshat te identifikuar dhe te krijoje modele zhvillimi te qëndrueshëm. Ai synon te rivitalizojë traditën, te përmirësoje autenticitetin dhe te rrisë atraktivitetin e vizitues mërinë e tyre.<br><br>Programi ka qene ndërsektorial, duke përfshirë portofolët e zhvillimit rural, kulturës, turizmit, infrastrukturës etj. Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ne nisje te kesaj nisme u investua per pajisjen me sinjalistike turistike e ketyre zonave dhe ne menyre shume aktive eshte lehtesuar procesi I certifikimit te subjekteve si subjekte te certifikuara agroturizmi I cili ka bere qe rreth 34 subjekte perfitojne nga lehtesite fiskale dhe te rriten pergjate | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kanë ndikuar këto investime në rigjallërimin e këtyre 100 fshatrave? | | procesit te operimit, duke krijuar me shume ekonomi dhe punesim ne zonat ku operojne, nderkohe qe 41 subjekte te tjera jane nxitur te investojne qe ne krye te heres dhe te krijojne biiznese qe nuk kane ekzistuar me pare dhe te terheqin investime thelbesore ne zonat rurale, njohuri, experience dhe punesim. | | |
| 77 | 18.12.2024 | Kërkesë për informacion ne lidhje me:• A ka një strategji kombëtare te integruar për markimin e destinacioneve turistike në Shqipëri?<br>•Cilat janë prioritetet kryesore të ministrisë për markimin e destinacioneve turistike?<br>• Si synohet te diferencohet Shqipëria nga destinacionet e tjera në rajon dhe me gjere?<br>• Si bashkëpunon ministria me bashkitë për markimin dhe promovimin e destinacioneve të veçanta?<br>•A ka programe financiare ose trajnime për bashkitë për te zhvilluar markën e tyre turistike?<br>• Cilat janë iniciativat kryesore të ministrisë për promovimin e | 24.12.2024 | Në vijim të e-mail-it tuaj, ju bëjmë me dije se MTM është në fazën përfundimtare për finalizimin e “Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2024-2030” të cilën po jua dërgojmë bashkëlidhur në të cilën gjeni të integruar edhe përgjigjet e pyetjeve që ju parashtroni.<br>Ky dokument strategjik është i një rëndësie të madhe në sektorin e turizmit për hartimin e politikave që do të zhvillojnë turizmin në shtatë vitet e ardhshme.<br><br>Sa më sipër, Strategjia Kombëtare e Turizmit 204-2030 mbështetet në gjashtë shtylla kryesore: Investimet, Politika fiskale dhe rregullatore në turizëm, Menaxhimi i destinacioneve, Zhvillimi i produktit turistik, Marketingu i destinacioneve dhe Ngritja e kapaciteteve mbështetur në tre parimet bazë që janë aspekti social, mjedisor dhe ekonomik”.<br>Gjithashtu kjo Strategji projekton krijimin, përmirësimin dhe konsolidimin e produkteve turistike duke e ndarë vendin në 6 rajone turistike: Rajoni turistik i bregdetit të Adriatikut, rajoni turistik verior i brendshëm, rajoni turistik i Tiranës, rajoni turistik i bregdetit të Jonit si dhe rajoni turistik jugor i brendshëm.<br>Po ashtu, ju bëjmë me dije se Ligji i ri i Turizmit zëvendëson atë të 2015-ës. Ndryshimet e reflektuara në | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | destinacioneve turistike shqiptare në tregjet ndërkombëtare?<br>• A janë planifikuar fushata të dedikuara marketingu për destinacionet shqiptare në vende specifike?<br>• A ekziston një marke kombëtare (logo, slogan) që përfaqëson turizmin shqiptar?<br>• Si ndihmon ministria në harmonizimin e markimit të destinacioneve lokale me atë kombëtar?<br><br>• Cilat janë politikat kryesore të ministrisë për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit?<br>• A ka fonde të dedikuara për zhvillimin e infrastrukturës turistike në destinacionet me pak te zhvilluara?<br>• Çfarë hapash po ndërmerren për të diversifikuar ofertën turistike (p.sh., agroturizmi, turizmi malor, turizmi kulturor)? | | ligjin e ri, u përgjigjen dinamikave të reja në sektor duke mbështetur zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm gjithëvjetor.<br>Si më poshtë, gjeni linkun për aksesim të Ligjit për Turizmin në faqen zyrtare të Ministrisë dhe të akteve ligjore dhe nënligjore.<br>https://turizmi.gov.al/strategjia-e-turizmit/ | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | • A disponon ministria të dhëna mbi numrin e turisteve dhe preferencat e tyre për destinacionet kryesore?<br><br>• Si matet ndikimi i fushatave të markimit dhe zhvillimit të turizmit?<br><br>• A ka projekte për të promovuar destinacionet më pak të njohura të Shqipërisë?<br><br>• Si përfshihen bizneset lokale dhe operatoret turistike ne zhvillimin dhe markimin e destinacioneve?<br>• A organizohen konsultime me komunitetin lokal për të garantuar që markimi dhe zhvillimi i turizmit reflekton interesat e tyre?<br>• Cilat janë sfidat kryesore qe ministria përballet në markimin dhe zhvillimin e turizmit?<br>•Cilët janë objektivat afatmesëm dhe afatgjate te | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ministrisë për përmirësimin e sektorit turistik? | | | | |
| 78 | 19.12.2024 | Kërkese për informacion ne lidhje me: nëse cirku Italian Marina Orfei ka bere kërkesë për eksportin e kafshëve për ti sjell në Shqipëri te këtij cirku?<br><br>A e keni miratuar ju lejen e importit te kafshëve ne Shqipëri te këtij cirku? Nëse po, lutemi te na vini ne dispozicion ketë leje. | 27.12.2024 | Janë vendosur në dispozicion lejet. | Përfunduar | 0 |
| 79 | 27.12.2024 | Kërkesë për informacion ne lidhje me: a ka kërkuar leje te ju ****për transport te mbetjeve apo kalim transit te mbetjeve.<br><br>Nëse po, kur konkretisht e ka kërkuar këtë leje.<br><br>Nëse ka marr leje për transport, ju lutem na i vini ne dispozicion një kopje te kësaj leje. | | Në proces | | |

**Shënim:**

Regjistri përditësohet çdo muaj.

(1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.

(2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.

(3) Identifikohet lloji i kërkesës.

(4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.

***(****Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale")*

(5) Ndihmon kërkuesin për të njohur ecurinë e procesit.

(6**)** Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.